



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2022, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE**  
**"KUZHINA QENDRORE", SHA, PRISHTINË**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara sipas pikës I të këtij vendimi, është 30.000 € (tridhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, mjete nga të hyrat vetanake.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, për realizimin e projektit për instalimin e paneleve solare.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-400/02-23676/22, më 28.10.2022**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Fehmi Kupina**

